



Permbledhje joteknike e aktiviteteteve

“Industria minerare, 3.9, Përpunimi, prerja dhe lustrimi i mermerit dhe gurëve dekorativ.”



Subjekti: “Pietra Nesli” sh.p.k

Hartoi: “EKO- STUDIO- PROJEKT” sh.p.k

Administrator: Shkelzen MADANI



Tirane, 2023



PERMBAJTJA

- ✚ Hyrje**
- ✚ Baza ligjore**
- ✚ Metodika e vleresimit te mjedisit**
- ✚ Objektivat dhe qellimi i VNM-se**

- 1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT**
- 2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI**
- 3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS**
- 4. MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE**
- 5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**



HYRJJE

Aktiviteti njerezor qe zhvillohet ne çdo aspekt te vetin, perveç dobesive ne menyre tepashmangshme krijon dhe “produkte” qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e qendrueshem te mjedisit. Pavaresisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proces. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktoje probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Se bashku me zhvillimin e madh qeeshtebere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane te patrajuara , emetimet e gazeve te demshem ne atmosfere, perdorimi i kimikateve te reja pa marre parasysh demet qe mund ti sjellin mjedisit kane sjelle problemet mjedisore me te cilat ne perballemi ne ditet e sotme.

Materiali qe paraqitet trajton ndikimet ne mjedisin fizik dhe human te aktivitetit:

BAZA LIGJORE

Relacioni u pergatit nezbatim teakteveligjoredhe nenligjoreMjedisore:

- *Ligji Nr.10 431, date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”*
- *Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »*
- *Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit neMjedis »*
- *Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes sekuqeteflores dhe faunes”*
- *Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelinkufi tezhurmave nemjedise te caktuara”*
- *Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”*
- *Ligji nr. 8897 dt. 16.05.2002 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”*
- *Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”*
- *Vendim nr.805 date 4.12.2003 « Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis per te cilat kerkohet leje mjedisore »*
- *Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin publik te mbeturinave »*
- *Udhezim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjese marrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit nemjedis »*
- *Udhezim nr.3 date 19.11.2009 ‘Per metodologjine e raportit te VNM’*
- *VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per lejemjedisi tetipave A,Bdhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mejdisit si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autori te te kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja ».*
- *Vendim Nr.13, date 04.01.2013” Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis”.*



1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT


Subjekti **"Pietra Nesli" sh.p.k** me administrator **Z. Musa Sulejmani** eshte regjistruar prane QKB me NIPT K53129001Q dhe do te ushtroje aktivitetin **"Përpunimi, prerja dhe lustrimi i mermerit dhe gurëve dekorativ"**. Aktiviteti do te zhvillohet ne adresen ne Godine nje kateshe, Dushnik, Otlak, Berat.

Aktiviteti qe do te zhvillohet, parashikohet te arrije nje kapacitet prodhimi prej **5 m³/dite**.

"Pietra Nesli" sh.p.k.



2/28/2023, 8:35:49 AM



AKPT

Koordinatat e prones ne sistemin Ghauss Kruger

	X	Y
1	4409855.29	4511928.58
2	4409935.41	4511927.91
3	4409936.87	4511883.78
4	4409942.75	4511883.86
5	4409946.74	4511736.09
6	4409910.32	4511749.78
7	4409878.92	4511771.28
8	4409851.50	4511803.86



Qellimi i projektit

Qellimi i aktivitetit është prerja, gdhendja dhe lustrimi i gurit të cilat përdoren në industrinë e ndertimit. Sheshi ku zhvillohet ky aktivitet është i sistemuar, aktiviteti zhvillohet brenda sipërfaqes së miratuar nga shoqëria. Brenda kësaj sipërfaqe është instaluar impianti për prerje, gdhendje dhe lustrim guri, gjithashtu dhe sheshi për depozitim të materialeve. Objekti disponon hapësirat e nevojshme për zhvillimin e proceseve teknologjike për prerje, gdhendje dhe lustrim guri, ku është instaluar dhe impianti me makineritë dhe pajisjet e domosdoshme.

Instalimet/Pajisjet e impiantit për prerje, gdhendje dhe lustrim guri

- Thyerësi i gureve
- Thika e prerjes me ujë
- Transportuesi
- Makineri për lucidim
- Pajisja e gdhendjes së gurit apo mermerit

Pershkrim i përgjithshëm

Impianti i prerjes, gdhendjes dhe lustrim guri funksionon mbi bazën e një procesi të thjeshtë fizik, i cili bën të mundur që lenda e parë që ka permasa të mëdha, i nënshtrohet proceseve fizike në linjen e prerjes, gdhendjes dhe lustrim guri, duke përfunduar në këto mënyra produktin e dëshiruar. Në këto godine realizohet punime të mermerit dhe gureve të tjera dekorative. Si lenda e parë për këto proces do të përdoren pllaka mermeri dhe gure dekorative dhe magazinohet në ambientet e jashtme të godinës pas prerjes, përpunimit dhe lustrimit. Procesi i realizimit të këtij produkti është i thjeshtë: merren pllakat e mermerit dhe gureve dekorative dhe priten në baze të porosive të ndryshme që merren. Prerja e pllakave të mermerit bëhet me sharre me ujë, ku pritet me permasa fikse. I gjithë ky proces kryhet me ujë që nuk lejon ngritjen e pluhurave. Pastaj mermeri i prerë apo guri dekorativ kalon për lustrim dhe lucidim, i gjithë ky proces kryhet me ujë që nuk lejon ngritjen e pluhurave.

Ambjentet e subjektit janë të mirë ajrosura. Copat e mermerit që dalin gjatë punës, nuk hidhen, por ripërdoren për të bërë mozaik. Për përpunimin e gurëve dekorativ përdoren makineri prerëse me disk diamanti, përpunimi me buratotriçe, prerje kubikesh me tranxha, gdhendje pllakash me çekiç gdhendes elektrik dhe përpunimi me dorë, në mënyra artizanale. Puntorët fillimisht kryejnë ndarjen e blloqeve në lastra më të vogla me trashësi sipas kërkesave të tregut duke filluar nga trashësia 5 mm deri në trashësinë 300 mm. Sipas kërkesave këto pllaka afrohen tek makineritë si: Tranxhë, Sharat prerëse të cilat në këtë impiant janë dy, Buratotriçe ose tek puntorët që do të kryejnë përpunimin si gdhendje dhe skalitje.

Në sharrat prerëse kryhet prerja e pllakave në madhësinë dhe formën që i kërkon tregu ose është kryerporosia nga klienti që kërkon të blejë. Tranxha kryen prerjet e pllakave në formë kubike dhe drejtëkëndshi në madhësinë dhe formën që i kërkon tregu ose është kryerporosia nga klienti që kërkon t'i blejë. Buratotriçja kryen larjen e të gjitha prodhimeve që janë



përgatitur për t'u tregtuar duke u dhënë formë sa më afër me atë natyrale. Puntorët kryejnë gdhëndje, skalitje dhe vendosjen në baleta të produktit përfundimtar. Prodhimi në baletat mbështillet me plastmas ose me rrjetë teli dhe ne kete forme eshte i gatshem per tu tregtuar ne tregun vendas ose ne eksport. Makineritë prerëse janë të lidhura me këtë depozitë me ndihmën e tubacioneve hidraulike.

Subjekti punon mbi bazen e porosive individuale te klienteles. Ai kryen te gjitha llojet e prerjeve dhe formave, prerje ne gjatesi, prerje ne trashesi. Formatet masive te mermerit, pllakat e mermerit, te granitive, me dimesione te medha dhe me trashesi te caktuar si dhe gurit dekorative me permasa dhe forme te crregullt. Sillen ne objekt me automjete perkatese dhe depozitohen ne sheshin perkatese. Shkarkohen me Vinc dhe me pas levizen me mjete te tjera ngritese dhe vendosen mbi bangon e prerjes te sharrave diskore. Disqet prerese, te cilet jane te perbere sipas shkalles se fortesise me aliazhe dhe lidhjesh metalike shume te forta, vihet ne levizje me ane te elektromotoreve. Gjate procesit te prerjeve krijohen pluhura mermeri, te cilat menjehere lagen, per te mos lejuar daljen e tyre ne mjedisin e punes. Per kete qellim ne zonen e prerjes hidhet uji, i cili sherben ne te njejten kohe edhe per ftohjen e tehut prerese te diskut te prerjes. Uji, me pluhurat e tretur ne te, derdhet ne sipërfaqen e pllakes se mermerit dhe te bangos se prerjes dhe nepermjet tyre derdhet mbi sheshin e prerjes, kanalet e brendshme e percjellin ne gropen e dekantimit te Ilumrave te mermerit, ku pasi arrihet nje nivel i caktuar behet terheqja e tyre nga subjekti i licensuar. Mbas prerje se formative te medhenje ne fleta ose pllaka mermeri me permasa relativisht te medha kalojne ne makinerite e lucidimit te cilat do te marrin shkelqimin e kerkuar dhe paraqitjen dekorative. Mbas prerjes se copave ne permasat e caktuara dhe te kerkuara, ate vendosen mbi nje bango tjetere ku ju behet rumbullakosja e buzeve te prerjes ose dhe ndonje punim tjetere i thjeshte, qe eshte kerkuar nga klientela. Per kete qellim perdoret guret zmerilo zmusuese. Gjate ketij procesi krijohen gjithashtu pluhurat e mermerit, te cilat edhe pse ne sasira te vogla, dalin direkt ne mjedisin e punes, ku punonjesit jane pajisur me mjetet e nevojshme te punes si maske, doreza, syze, tapa per veshet, kominoshe, kepuce me maje metalike etj. Punonjesit qe punojne jane te paisur detyrimisht me maska antipluhur.

2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI

Pozita Gjeografike

Berati ndodhet në jug të vendit. Ai është i rrethuar nga male dhe kodra, duke përfshirë Tomorrit në lindje që u shpall park kombëtar. Lumi Osum (gjatësia totale 161 km (100 mi)) përshkon qytetin përpara se të derdhet në Seman brenda fushës së Myzeqesë. Bashkia e Beratit u formua në reformën e qeverisjes vendore të vitit 2015 nga bashkimi i ish-bashkive Berat, Otlak, Roshnik, Sinjë dhe Velabisht, të cilat u bënë njësi bashkiake. Selia e bashkisë është qyteti Berat. Popullsia e përgjithshme është 60,031 (regjistrimi 2011), në një sipërfaqe totale prej 380,21 km² (146,80 mi katrorë). Popullsia e ish-komunës në regjistrimin e vitit 2011 ishte 32,606. Berati, i shpallur në listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s në vitin 2008, përmban një stil unik arkitekture me ndikime nga disa qytetërime që kanë arritur të bashkëjetojnë për shekuj përgjatë historisë. Ashtu si shumë qytete në Shqipëri, Berati përbëhet nga një qytet i vjetër i fortifikuar i mbushur me kisha dhe xhami të pikturuara me



një pasuri madhështore muralesh dhe afreskesh të dukshme. Berati është një nga qendrat kryesore kulturore të vendit.


Kushtet klimatike

Shqipëria, ashtu si edhe vendet e tjera mesdhetare, karakterizohet nga vera të nxehta e të thata dhe dimra të butë dhe të lagët. Pavarësisht sipërfaqes relativisht të vogël, ajo ka një shkallë të lartë të pazakontë të ndryshimeve rajonale klimatike. Shqipëria ndahet në katër zona kryesore klimatike: Mesdhetare Fushore, Mesdhetare Kodrinore, Mesdhetare Paramalore dhe Mesdhetare Malore. Zona e propozuar për zhvillimin e këtij aktiviteti gjendet në pjesën lindore të nënzonës së Klimës Mesdhetare Fushore. Regjimi klimatik është tipik mesdhetar. Karakterizohet nga reshje të bollshme gjatë vjeshtës dhe dimrit, kryesisht në formë shiu. Bora është një dukuri e rrallë dhe sasitë janë të papërfillshme. Kjo zonë ka 2550.0-2850.0 orë me diell. Analiza e kushteve klimatike bazohet në të dhënat e regjistruara gjatë periudhës 19951-1990 nga stacioni meteorologjik i Sinjës, më i afërti me zonën e projektit. Pas kësaj periudhe, matjet nuk janë regjistruar rregullisht. Lagështia relative vjetore është 68-72 %, shpejtësia mesatare e erës 2.0 – 3.5 m/s dhe drejtimi dominant është ai i veriperendimit.

Temperaturat e ajrit

Temperatura mesatare vjetore e ajrit në zonën e projektit është 12.9 °C. Muaji më i ftohtë është janari me një temperaturë mesatare prej 5.3 °C, ndërsa temperatura mesatare e gushtit (muaji më i nxehtë i vitit) është 21.6 °C. Minimumi absolut i temperaturës prej -11.6°C është vërejtur në janar në Sinjë. Temperatura maksimale absolute është 37.6 °C, dhe është regjistruar në 18 Korrik 1973.

Temperatura	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Kor	Gus	Sht	Tet	Nën	Dhj	Vjetore
Mesatarja vjetore	5.3	6	7.8	10.2	14.9	18.9	21.2	21.6	18.5	14	9.7	6.7	12.9
Maksimalja absolute	18.6	21.1	23.4	27.4	29	36.2	37.6	36.6	32.7	30.6	24.3	20.6	37.6
Minimalja absolute	-11.6	-8	-9.8	-3.1	2.5	5.2	7.7	6.4	5.5	0.7	-6.8	-11.9	-11.9





Reshjet

Sasia mesatare e reshjeve vjetore në zonën e projektit është 1437 mm, pak më e lartë se mesatarja vjetore prej 1400 mm. Sasia më e madhe e reshjeve pritet gjatë periudhës së ftohtë të vitit. Referuar të dhënave të regjistruara nga stacioni i Sinjës muaji më i lagësht është nëntori me 179 mm, ndjekur nga janari dhe dhjetori me 156 mm dhe 149 mm përkatësisht. Reshjet më të mëdha në Sinjë janë regjistruar në 1963-in, rreth 1900 mm, dhe ato më të pakta në 1987-ën, afërsisht 800 mm. Shpesh sasia ditore e reshjeve i kalon 100 mm, dhe maksimumi absolut ka arritur në 161 mm gjatë 24 orëve në stacionin meteorologjik të Sinjës. Duke marrë parasysh sasinë maksimale të reshjeve në 24 orë dhe intensitetin për intervale të ndryshëm në periudha të ndryshme përsëritjeje, zona karakterizohet nga shira me intensitet normal.

Parametri	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Kor	Gus	Sht	Tet	Nën	Dhj	Vjetore
Mesatarja reshjeve ^e	156	141	114	117	110	70	47	45	84	125	179	149	1437
Maksimumi 24h i reshjeve	81	78	81	71	155	70	62	75	60	161	97	90	161

Relievi

Rrethi i Beratit shtrihet kryesisht në një territor me reliev malor e kodrinor, me lartësi mesatare mbi nivelin e detit 455 m (qyteti 58 m). Fushat shtrihen në krahun veri-perëndimor të rrethit, në luginën e Osumit, derisa ajo bashkohet me fushën e Myzeqesë. Në mjedisin natyror të Beratit dallohen: zona fushore e kodrinore e Beratit dhe e Kuçovës, mali i Tomorit (Lindje, 2417 m) dhe ai i Shpiragut (Perëndim, 1218 m) si edhe lugina e Osumit dhe e Tomoricës. Zona fushore dhe ajo kodrinore janë baza e zhvillimit të prodhimit bujqësor, ndërsa malet dhe luginat përfaqësojnë burime të mëdha pyjore, kullosore dhe hidrike, ende të pashfrytëzuara si potenciale të rëndësishme të zhvillimit ekonomik e mjedisor.

Toka/Flora/Fauna

Vendi ku kerkohet leja e shfrytezimit është pothuajse i zhveshur nga bimesia. Rriten vetëm pak shkurre të vogla barishte. Te gjitha llojet e bimeve, që rriten përreth objektit janë të karakterit lokal pa ndonjë veçori dalluese dhe që nuk gëzojnë ndonjë status të veçantë mbrojtjeje. Brenda zonës së shfrytezimit janë të zhvilluar në mënyrë të kufizuar shkurret dhe bimët lokale.

3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

Çdo aktivitet që zhvillohet shoqërohet me pasoja dhe ndikime në mjedis, që janë pjesë e atij kompromisi që shoqëria jone ka zgjedhur për të zhvilluar. Megjithatë e rëndësishme është që të kuptohet natyra e këtyre proceseve, forma e shfaqjes së tyre dhe me analitikisht ndikimet e çdo operacioni të kryer.



Shkarkime ne uje

Ne procese teknologjike te impiantit te perpunimit te gurit dekorativ do te perdoret uji. Te gjitha makinerite e montuara ne kete impiant me perjashtim te tranxhes e kane domozdoshmeri perdorimin e ujit. Uji njekohesisht do perdoret per lagien e territorit per paksimin e pluhurave. Ujrat e ndotura nga procesi teknologjik dhe nga pluhurat e krijuara do te depozitohen ne vaskat e ndertuara ne sheshin e impiantit.

Emetimet ne ajer

Emisione gazesh gjate aktivitetit do te kemi ne disa veprimtari. - Perdorimi i gjeneratorit ne rastet kur nderpritet energjia elektrike - Mjetet e transportit qe sjellin lenden e pare transportojne produktin perfundimtare, mjetet e punonjesve dhe vizitoreve. Mundesia e shkarkimit te pluhurave eshte gjate levizjes se automjeteve sepse gjate procesit te prerjes duke qen se kemi perdorim te ujit nuk gjenerohen pluhura.

Zhurmat dhe vibrimet

Zhurma dhe vibrime ne mjediset e jashtme do te jene prezent gjate zhvillimit te aktivitetit pajisjet e instaluara sharrat, tranxhat etj si dhe nga makinat e transportit te lendes se pare dhe produktit perfundimtar.

Mbetjet e prodhuara

Nga zhvillimi i aktivitetit “Përpunimi, prerja dhe lustrimi i mermerit dhe gurëve dekorativ”, nuk do te kemi gjenerim te mbetjeve te copave te gurit dekorativ pasi ato riperdoren per mozaik sipas kerkeses se klienteles.

Mbetjet te cilat do te gjenerohen nga aktiviteti i perditshem i punonjesve si kartona apo plastika do te grumbullohen si fillim ne vendin e percaktuar nga drejtuesit dhe me pas do te dergohen ne vendin e percaktuar nga Njesia e qeverisjes vendore. Theksojme se nuk do te kemi kemi gjenerime te mbetjeve te rrezikshme.

Ndikime ne biodiversitet

Gjate fazes se funksionimit te ketij aktiviteti nuk do te kemi ndikime ne biodiversitet. Flora dhe fauna e zones nuk do te ndikohet nga aktiviteti i shoqerise.

4. MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

Masat per shkarkimet ne uje

Ne procese teknologjike te impiantit te perpunimit te gurit dekorativ do te perdoret uji. Te gjitha makinerite e montuara ne kete impiant me perjashtim te tranxhes e kane domozdoshmeri perdorimin e ujit. Uji njekohesisht do perdoret per lagien e territorit per paksimin e pluhurave. Ujrat e ndotura nga procesi teknologjik dhe nga pluhurat e krijuara do



te depozitohen ne vaskat e ndertuara ne sheshin e impiantit. Keto ujra do te depozitohen per ne vasken e dekantimit te llumrave te mermerit, ku pasi plotesohet niveli kryehet terheqja ng subjekti i licensuar. Ujrat sanitare qe do te gjenerohen nga aktiviteti i perditshem i punonjesve do te shkakrohen ne rrejtin egzistues te kanalizimeve te zones, por keto nuk konsiderohen shkarkime pasi nuk vijne si pasoj e zhvillimit te procesit teknologjik.

Masat per emetimet ne ajer

Gjatë fazës së operimit burimet nga të cilat shkaktohen dhe emetohen gaze dhe grimca të ngurta janë: lëvizja e automjeteve dhe proceset teknike të operimit. Për këto aktivitete kompania të zbatojë masat zbutëse e mëposhtme:

- Lënda djegëse e cila do të përdoret nga mjetet dhe automjetet që do të operojnë gjatë fazës furnizimit dhe transportit të gureve dekorativ të jëtë e një cilësie të mirë.
- Mjetet dhe automjetet që do të përdoren do t'i nënshtrohen kontrolleve teknike periodike.
- Mjetet dhe automjete që do të përdoren nuk do të jenë të amortizuara të cilat mund të shkaktojnë emetime të gazeve në nivele të larta në atmosferë.
- Të realizohet spërkatja e ambjentëve në mënyrë që të reduktohet sasia e pluhurit që mund të shkaktohet gjatë lëvizjes së automjeteve.
- Ambjentet përrehtë spërkatën me ujë për të shmangur pluhurin.

Zhurmat dhe vibrimet

Zhurma dhe vibrime ne mjediset e brendshme do te jene prezente gjate zhvillimit te aktivitetit por gjithmone keto emetime jane ne norme te lejuar. Te gjithë punonjesit qe do te kryejne kete proces do te pajisen me kufje.

Ne mjediset e jashtme zhurmat dhe vibrimet do te jene prezent vetem gjate levizjes se automjeteve te transportit te lendeve te para dhe te marrjes se lendes perfundimtare. Per uljen e ketij ndikimi, te gjitha mjetet e renda qe kryejne transportin e lendeve, do te behet kontrolli periodik, per te kontrolluar gjendjen e tyre teknike.

Mbetjet e prodhuara

Nga zhvillimi i aktivitetit “Përpunimi, prerja dhe lustrimi i mermerit dhe gurëve dekorativ”, nuk do te kemi gjenerim te mbetjeve te copave te gurit dekorativ pasi ato riperdoren per mozaik sipas kerkeses se klienteles.

Mbetjet te cilat do te gjenerohen nga aktiviteti i perditshem i punonjesve si kartona apo plastika do te grumbullohen si fillim ne vendin e percaktuar nga drejtuesit dhe me pas do te dergohen ne vendin e percaktuar nga Njesia e qeverisjes vendore. Theksojme se nuk do te kemi kemi gjenerime te mbetjeve te rrezikshme.

Masat per mbrojtjen kunder zjarrit

Masat per mbrojtjen kunder zjarrit jane shume te rendesishme. Ato jane parashikuar ne projekt dhe jane si me poshte:

- Largimin e materialeve te ndezshme nga ambjentet e godines dhe vendosjen e tyre ne vende te sigurta per parandalimin e transmetimit te zjarrit



- Mbajtje e lire e rrugeve te largimit
- Mirembajtje dhe kontroll i vazhdueshem i instalimeve elektrike ne perputhje me rregullat perkatese per instalime te tilla.
- Pozicionimi i shenjave ne vende te dukshme dhe vendosja e instruksioneve per veprimet qe duhet te kryeje personeli ne rast zjarri.
- Pozicionimi i shenjave qe paraqesin pozicionet e shuaresve te zjarrit, rruget e largimit dhe daljet e emergjnces.
- Duke marre ne konsiderate karakteristikat e nderteses si dhe destinacionin e saj jane perdorur substanca shuaresive si me poshte:
 - Sistem i mbrojtjes me uje me hidratante te jashtem
 - Sistem i mbrojtjes me uje me hidtrante te brendshem
 - Shuares portable ne te gjitha pozicionet te cilat parashikohen ne projekt.

Mbrojtja nga aksidentet dhe kushtet ne pune

Detyrimet e punëdhënësit

Per te shmangur aksidentet ne pune, punëdhënësi vetë i ka bërë të ditur punëmarrësve:

- Proçesin teknologjik në tërësi dhe specifikat e punës në vendin e punës ku punon secili.
- Pajisjet dhe makineritë që janë në përdorim.
- Mundësitë për aksidente, shkaqet dhe masat për mënjanimin e tyre.
- Rregulloret e sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë në Republikën e Shqipërisë, aktet ligjore dhe udhëzimet në zbatim të tyre, lëshuar nga institucionet përgjegjëse.
- Veçoritë e punës në instalimin ku do të punohet, rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë për të shmangur aksidentet dhe ruajtur shëndetin e punonjësve që do të punojnë.

Detyrimet e punëmarrësit:

- Të njoh mirë proçesin e punës dhe makinerite apo pajisjet që ka në përdorim.
- Të njoh rregullat e sigurimit teknik që lidhen me frontin e punës ku punon.
- Të mbrojtë veten dhe shokët gjatë punës.
- Kur konstaton rrezik apo mundësi të ndodhjes së avarive që çojnë në rrezikim të jetës, të dijë çfare masash duhen marrë për shmangien e rrezikut.
- Të dijë të përdorë mjetet mbrojtëse në punë.
- Të ketë njohuri të mjaftueshme per ndihmën e shpejtë.
- Te mos perdore pije alkoolike para fillimit te punes dhe gjate kohes se punes.